

Data 24.07.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: *Ndërtim i parkimit me 1 kat nëntokë, objekti 3 kat I bashkisë dhe rehabilitimi i sheshit,*

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2 punime ndertimi

Afati i realizimit të punimeve është 24(njezet e kater) muaj , sipas grafikut te punimeve.
Garancia per mbulimin te difekteve ,që mund te lindin gjatë shfrytëzimit të objektit , nga ana e firmës të jetë 2 vjet .

Vlera e fondit limit: *533,886,935 (pesëqind e tridhjetë e tre milionë e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa tvsh.*

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, **Bashkia Kamëz**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1. Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

- Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas **shtojcës 8 të DST**
- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim për deklarimin e xhiros vjetore, të konfirmuara me vulë pranë autoriteteve përkatëse (Administratës Tatimore) të tre viteve të mëparshme (**2022, 2023, 2024**), në të cilat duhet të rezultojë se vlera e xhiros minimale vjetore të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet (vlera e kontratës që prokurohet).

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (e ndryshuar)”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr.10091 date 05.03.2009 “*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*” (i ndryshuar).

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit financiare (**2022, 2023, 2024**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit). Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për

*auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet **për vitin 2025** (këstet e maturuara). (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore .

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) si dhe sipas Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se **40 % te fondit limit** të perllogaritur të prokurimit pa tvsh të realizuar nga operatori ekonomik gjatë pesë viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

ose

- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të perllogaritur të prokurimit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontratë Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikate e perkoheshme /e perhershme e marrjes në dorezim

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vleresimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posacme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 533,886,935.12 lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 1,067,773,870.24 lekë pa TVSH. Plotesimi i njerit prej dy kushteve të sipërpermendura e bën ofertën e kualifikueshme. Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. ”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku përcaktohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. **Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”.**

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave

1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa më të drejtë të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa më të drejtë, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte.

Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jepen të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), ku ndër të tjera përcaktohet se: ***Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.***

2.4 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastruktura dhe Energji, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P – 1 A Punime gjurmimi në tokë;
- N.P – 2 F Ndertime Civile dhe Industriale;
- N.P – 10 A Ndertimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike
- N.P – 12 B Punime të inxhinierisë mjedisore

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S – 1 A Punime për prishjen e ndertimeve.
- N.S – 2 A Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
- N.S – 3 A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse,

transportues).

- N.S – 4 B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese
- N.S – 8 A Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
- N.S – 9 D Punime strukturore speciale
- N.S – 12 A Impiante teknologjike, termike dhe te kondicionimit.
- N.S – 14 A Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- N.S – 18 A Punime topogjodezike

Argumentimi:

N.P-1 A (Punime gjërmimi në tokë)

Ne kete projekt trajtohen gjërmimet per ndertimin e objektit perkatesisht godines civile dhe parkimit nentokesor, do te kryhen punime gjërmimi dhe transporti per per linjat e furnizimit me energji elektrike, linjat e furnizimit me uje dhe linjat e drenazhimit. Gjërmimet dhe mbushjet akseset, kalimet , pjerresite, per ndertimin e strukturave dhe te tjera si keto duhet te behen ne format dhe dimensionet e treguara ne vizatimet perkatese, vetem ne rastet e ndryshimeve te mundshme qe punedhenesi do te adoptoje, dhe te gjitha kostot qe sjellin keto lloj punimesh do te jene ne ngarkim te kontraktorit, duke perfshire edhe ato per punimet mbrojtese apo te perforcimeve te mundshme, te gjitha keto duhet te jene llogaritur nga ai ne vendosjen e çmimit per njesi. Pjerresite e gjërmimeve dhe mbushjet duhet te kryhen sipas pjerresise se pershtatshme sipas natyres dhe karakteristikave fiziko-mekanike te formacioneve.

Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

N.P-2 F (Ndertime civile dhe industriale)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtëpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Ne kete projekt kemi te bejme me ndertimin e nje objekti te ri civil-administrativ me te gjithë elementet perberen (mbrojtja , struktura, instalimet elektrike, hidraulike, mekanike dhe mbrojtjes nga zjarri).

Niveli i klasifikimit është F. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e madhe se 401 milion leke dhe me e vogël se 800 milion leke.

N.P-10 A (Ndertimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, ose që janë të nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike, të kompletuara me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, përfshirë edhe të gjitha impiantet mekanike, elektromekanike elektrike, telefonike, elektronike, të nevojshëm për funksionim, sigurim dhe asistencë. Përfshin hidrocentralet, termocentralet dhe panelet fotovoltaike.

Ne kete projekt kemi te bejme me ndertimin e paneleve fotovoltaike per prodhim te energjise elektrike te cilat do te perdoren per furnizimin me energji te objektit te ri qe do te ndertohej.

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

N.P - 12 B “Punime të inxhinierisë së mjedisit”

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktimit të zhvillimit të qëndrueshmërisë të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit tepërdorur për karriera guri, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrit hidrojologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpatëve dhe rripullëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpave rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventiv në seksionet “Punime Germimi ” dhe “Punime Shtresash”. Kjo kategori është kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime germimi, mbushje dhe punime shtresash të cilat prekin një sipërfaqe të madhe dhe rrjedhimisht germimi i një sipërfaqe të tillë sjell ndikim mjedisor. Gjithashtu duke qenë se kemi një hapësirë të konsiderueshme ndërtimi në projekt dhe preventiv janë parashikuar një seri punimesh të gjelbërimit të cilat lidhen me këto pike.

Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse: Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar (21-50 milion lekë).

Licencat për punimet e përgjithshme të ndërtimit janë kërkuar bazuar në zërat e punimeve të preventivit, referuar vlerave të preventivuara për çdo kategori licence.

N.S-1 A (Punime per prishjen e ndertimeve)

Me punime të tilla, sipas **VKM nr.42 të datës 16.01.2008** më sipër cituar Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksplozivi me prerje të strukturave betonarmeje dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve .

Për zbatimin e punimeve të prishjeve të parashikuara në projektin e zbatimit është e domosdoshme që OE të zotërojë kapacitetet përkatëse të konfirmuar me pikën përkatëse të licensës së nevojshme për zbatimin e punimeve të tilla.

Kategoria A i referohet vlerës së këtyre punimeve në preventivin total dhe përcaktimeve të VKM Nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S-2 A (Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre)

Me punime të tilla, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar konsideron, montimin, mirëmbajtjen ose ristrukturimin e impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Për zbatimin e projekteve të impianteve hidrosanitare dhe atyre të mbrojtjes nga zjarri, të parashikuara në projektin e zbatimit është e domosdoshme që OE të zotërojë kapacitetet përkatëse të konfirmuar me pikën përkatëse të licensës së nevojshme për zbatimin e punimeve të tilla, sikurse parashikohet në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, pika 1.1 më sipër cituar. Vendosja e këtij kriteri i referohet zgjidhjeve grafike, preventivit, specifikimeve teknike, relacioneve të projektit hidroteknik dhe atij të mbrojtjes nga zjarri, si dhe grafikut të punimeve për zbatimin e projektit total. Në projektet respektive parashikohen impiantet hidrosanitare të furnizimit me ujë të tualeteve dhe të gjitha masat për mbrojtjen nga zjarri të objektit. Këtu përfshihen të gjitha punimet për instalimin e këtyre rrjeteve, si dhe pajisjet dhe impiantet për vendosjen e tyre në funksion.

Kategoria A i referohet vlerës së këtyre punimeve në preventivin total dhe përcaktimeve të VKM Nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S - 3 A Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, me punime për impiante ngritëse dhe transportuese konsiderohet, montimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Komunikimi vertikal në objektin e parashikuar të ndërtohet është konceptuar të zgjidhet nëpërmjet impiantit ngritës dhe transportuese siç janë ashensorët. Në objekt është parashikuar furnizimi dhe

montimi i ashensorit. Ky element strukturor është paraqitur në të gjitha paraqitjet grafike në planimetri dhe në preventivin e punimeve për zbatimin.

Punimet për montimin e ashensorit në vepër dhe vendosjen e tij në funksion duhet të kryhen nga subjekte, të cilat referuar legjislacionit duhet të zotërojnë licensën e posaçme për impiante ngritëse dhe transportuese. Nisur nga vlera e këtyre punimeve në preventiv, të tilla punime janë përcaktuar në kategorinë A, në përputhje me VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar

NS 4 –B Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashme, të veshjeve të brendshme dhe të jashme të dysHEMEVE të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm. Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Për zbatimin e punimeve të rifiniturës të muraturës dhe të lidhura me to të parashikuara në projektin e zbatimit

Niveli i klasifikimit është B. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, varion nga 21 milion deri në 40 milion .

• ***NS 8 –A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.***

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi i elementeve si guard rail, Neë Jersey, zvogëluesit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa. NS-8 a. Ndërtime parafabrikat beton arme. Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur. NS-8 b. Struktura metalike. Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër. NS-8 c. Struktura druri.

Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë metalik të drejtë të trajtuar përpara niveli i klasifikimit është A. Në këtë projekt kemi të bëjmë me struktura metalike (shkallet e mergjences) prandaj është e domosdoshme që OE të zotërojë kapacitetet përkatëse të konfirmuar me pikën përkatëse të licensës së nevojshme për zbatimin e punimeve të tilla

Niveli i klasifikimit është A. Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, është me e vogël se 20 milion leke.

N.S – 9 D Punime strukturorë speciale.

Me punime strukturore speciale VKM Nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar *konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistonte dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampionëve për analiza laboratorit nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve.*

Projekti, objekt i kësaj procedure, sikurse u përmend më sipër parashikon ndërtimin e një ndërtese të re, të përbërë nga objekti civil-administrativ dhe ndërtimi i parkimit nëntokësor. Në projektin strukturor janë parashikuar punime të tilla si punime për strukturave mbajtëse. Këto nënçera përfshihen në zërin punime betoni dhe betonarmeje të preventivit të punimeve. Punime të tilla janë punime strukturore speciale për zbatimin e të cilave subjektet duhet të disponojnë licensën përkatëse.

Nisur nga punimet e parashikuara në projektin teknik të zbatimit, është e nevojshme që OE të zotërojë kapacitetet për realizimin e punimeve të tilla, sipas përcaktimeve të VKM Nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar, ku nisur nga pesha që zënë këto punime në preventivin total, përfshihen në kategorinë D.

N.S - 12 A Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

Sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar punime të tilla *konsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose rishikimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.*

Referuar VKM Nr. 418, datë 10.5.2017 “Për Standardet, Kriteret dhe Procedurat për Hapjen, Riorganizimin, Ndarjen, Bashkimin dhe të Degëve të tyre”, Pika 2.c.) Standarde dhe normativa për infrastrukturën e IAL-së, paragrafi ë):

ë) Mjediset duhet të jenë të pajisura me sisteme funksionuese ngrohje-ftohjeje.

Objekti i parashikuar të ndërtohet do të pajiset me sistem të plotë HVAC. Sistemi i propozuar në projektin HVAC është konceptuar posaçërisht për funksionin e ndërtesës. Komforti termik, qarkullimi i mirë i ajrit dhe lagështia relative e krijuar në ambient është shumë e rëndësishme në objektet e kësaj natyre. Në projektin mekanik HVAC, duke përfshirë zgjidhjet grafike, relacionin teknik, specifikimet teknike, si dhe pjesën përkatëse të preventivit dhe grafikut të punimeve për realizimin e secilit seksion të ndërtesës janë parashikuar të gjitha punimet për ndërtimin e rrjeteve, furnizimin dhe montimin e këtij sistemi.

Për realizimin e këtyre punimeve në kriteret teknike është kërkuar që OE të zotërojë kapacitetet teknike profesionale për zbatimin e sistemit të plotë të ngrohjes, ftohjes dhe ventilimit, në

përputhje me zgjidhjet teknike të hartuara nga projektuesi. Vendosja e këtij kriteri kushtëzohet nga punimet e parashikuara të realizohen për kompletimin dhe përmbylljen e veprës. Nisur nga natyra e punimeve dhe vlerat e preventivit për zbatimin e tyre, është e domosdoshme që OE të jetë i pajisur me licensën respektive N.S - 12 A, sipas VKM nr.42 të datës 16.01.2008 më sipër cituar.

N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.

Me impiante të kësaj tiplogjie, në shtjellim të N.S – 14 konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Projekti i zbatimit parashikon ndër të tjera zbatimin e punimeve për rrjetet elektrike dhe elektronike, të tilla si punimet për instalimin e rrjetit elektrik të furnizimit me energji, rrjetin e tokëzimit dhe rrufepritjes, ndriçimin, rrjetin lan, CCTV dhe telefoninë, pajisje sistemi i zbulimit dhe lajmërimit të zjarrit, sistemi audio, sistemi i sigurisë dhe kontrollit të hyrje – daljeve.

Punime të tilla duhet të realizohen nga subjekte të kualifikuara për realizimin e tyre, në përputhje me VKM nr.42 të datës 16.01.2008, më sipër cituar. Licensa e nevojshme për realizimin e këtyre punimeve, referuar këtij akti është N.S-14-A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV. Kategoria A i referohet vlerës së punimeve të tilla në preventivin e punimeve.

N.S-18 A “Punime topogjeodezike”:

Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv në seksionet 2.“Punime Germimi ” dhe 3.“Punime Shtresash”, konkretisht këtu përfshihen të gjithë zërat e punimeve të rubrikave në seksionet e lartepërmendura”.

Duke patur parasysh që objekti do të ndertohet në një territor të ri duhet , punimet topografike duhet të jenë të shumta dhe nivilimi i shesheve duhet të bëhet në mënyrë që mos të ketë probleme me kullimit gjatë shirave.

Kategoria A i referohet vlerës së punimeve të tilla në preventivin e punimeve.

Licencat për punimet speciale të ndërtimit janë kërkuar bazuar në zërat e punimeve të preventivit, referuar vlerave të preventivuara për këtë kategori licence.

2.5 Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklarate nga (Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili të jetë i përfshirë në licencën e

shoqërisë, dhe që do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesë të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit).

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paafësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.6 Operatori ekonomik duhet të kete nje numer mesatar te punonjësve të siguruar jo më pak se **125 punonjës** të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Maj 2025 – Qershor 2025**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Maj 2025 – Qershor 2025**
- Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Maj 2025 – Qershor 2025**

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej 125 punonjës, për të paktën 2 muajt e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-së dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjësve i kërkuar është në përputhje me përmasat dhe specifikat e kontratës. Në përllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-së dhe legjislacionit tatimor, janë përcaktuar dokumentet konkrete që duhet të paraqiten nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për përmbushjen e këtyre kushteve. Në përllogaritjen e numrit të punonjësve përfshihen punonjësit inxhinierë, specialistë, punonjës të kualifikuar dhe punëtorë për punime me krahë, drejtuesit e mjeteve të thjeshta apo të rënda etj., duke pasur parasysh njëkohësisht volumin e lartë të punimeve.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 128 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatim të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 24 muajve kalendarikë, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar) sipas së cilës: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

2.7 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit, konkretisht:

- | | |
|---------|--|
| 1 (një) | Inxhinier Ndërtimi (profili Civil/Strukturist) |
| 1 (një) | Inxhinier Hidroteknik |
| 1 (një) | Inxhinier Elektroteknik |
| 1 (një) | Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder |
| 1 (një) | Inxhinier Mekanik |
| 1 (një) | Inxhinier Mjedisi |

Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve ekonomik, sipas punimeve qe merr persiper te realizoje referuar Preventivit te punimeve, secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt, të cilët duhet të jetë te përfshirë në liçencën e shoqërisë.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Liçencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Liçencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar N.P –2, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit** (profili Civil/Strukturist). Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një sasi dhe tipologji të madhe të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e prishjes, punimet e gërmimit, punimet e konstruksionit (thmelet, trare,kollona,soleta b/a etj) punimet e shtresave, punimet e muraturës, suvatimet, hidroizolimet, sistemimet e jeshtme etj. Punimet ndërtimore përbëjnë pjesën më të madhe të vëllimit të punëve për zbatimin e projektit, sikurse edhe ato më komplekset. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore, plotësimi i kërkesave për mbrojtjen nga zjarri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetit e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element

dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës.

Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndjekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standartet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi, i profilit strukturist. Ndjekja e të gjithë procesit ndërtimor që në fazën e pastrimit të sheshit, punimet e ngritjes së kantierit, skelerive, objekteve ndihmëse, punimet e muraturës, punimet e shtresave izoluese, realizimi i daljeve për sistemet teknike të ndërtesës realizimi i strukturës mbajtëse, punimet për realizimin e konstruksioneve metalike të thjeshta dhe të përbëra janë punime të parashikuara në projektet e punimeve ndërtimore dhe në preventvin respektiv.

- Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kerkuar **N.S-2 A**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**, pasi është përgjegjes për linjat e furnizimit me ujë , shkarkimeve dhe instalimet e brendshme hidrosanitare.
- **Inxhinieri Elektroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike dhe sistemet e kontrollit lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv, sipas parashikimeve në projektet Elektrike përkatëse.
- **Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të germimit të themeleve, kuotave tubacioneve të kanalizimit, kuotave të shtresave. Duke ju referuar punimeve që do të kryhen në këtë zbatim sipërfaqja e shesheve është 8000 m² dhe ka një sipërfaqe të konsiderueshme ku është e nevojshme prania e 1 inxhinieri Topograf për të realizuar në të njëjtë kohë të dyja objektet si sheshin që duhet të ruhen patjetër kuota për të bërë dranzhimin e ujit dhe ndërtimi i objektit godine dhe parkim nertokesor.
- **Inxhinier Mekanik** është përgjegjes për instalimet e sistemit të HVAC referuar preventivit të punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kerkuar **N.S-12 A**.
- **Inxhinier Mjedis** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve, të parashikuara në preventiv në seksionet 2.“Punime Germimi ” dhe 3.“Punime Shtresash”

- Referuar preventivit te punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar NS 4A, është e nevojshme prezenca e **Arkitektit** , Projekti arkitekturor duhet të zbatohet në përputhje me konceptin e përgjithshëm arkitekturor të projektit të zbatimit të hartuar nga projektuesi arkitekt. Zërat e punimeve që përfshin ky projekt përmbajnë ndër të tjera punime të rifiniturave, punimet e dyerve, dritareve dhe fasadave etj. Këta zëra punimesh u nështrohen kërkesave të projektit arkitekturor të zbatimit, kërkesave estetike, higjeno – sanitare, funksionale të specifikuara në këtë projekt. Konceptimi i brendshëm hapsinor duhet të respektojë rigorozisht zgjidhjet teknike të hartuara nga projektuesi arkitekt. Zgjidhjet planimetriko – hapsinore të projektit në fjalë janë relativisht komplekse. Është e rëndësishme që në vëllimet që ndërtohen të vendoset për përdorimin e materialeve në ndërtesë, ngjyrave të ndryshme të materialeve, duke i shërbyer anës estetike, ekuilibrit të ndërtesës në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi. Në përputhje me specifikimet teknike të punimeve ndërtimore, që shoqërojnë projektin arkitekturor, punë të caktuara duhet të projektohen dhe instalohen nga ekspertë të veçantë. Këtu përfshihen të gjitha fasadat e xhamit, fasa e ventiluar dhe instalimet e dritareve përfshirë pusët e dritës, Sistemi i Përbërë i Integruar i Termoizolimit të Jashtëm, të gjitha punimet dhe strukturat metalike, të gjitha dyert e veçanta (p.sh.: dyert anti-zjarr apo të sigurisë), të gjithë elementët e mobiljeve urbane që janë prodhuar dhe montuar enkas, të gjithë elementet e detajuar të infrastrukturës urbane (kapakët e pusëve, kapakët e kanaleve të kullimit, etj.

Për zbatimin e saktë të projektit të zbatimit arkitekturor, i cili sikurse është shtjelluar më sipër parashikon ndërtimin e një vëllimi është kërkuar angazhimi i një arkitekti ose urbanist të licensuar të jetë i përfshirë në licensën e shoqërisë.

2.8 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf mbështetës jo domosdoshmërisht të përfshirë në licensën e shoqërisë për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse, CV, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për muajin e fundit:

- 1 (një) Inxhinier Elektronik
- 1 (një) Inxhinier Materialesh
- 1 (një) Inxhinier Gjeoinformatik

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në germën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c/ç të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Këto kritere i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të zbatimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të veprës.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar janë kërkuar ekspertët arkitektë/urbanist, dhe inxhinierë të licensuar, sipas profileve të domosdoshme për të mbuluar të gjitha punimet e parashikuara në projekt – zbatimin e parashikuar të realizohet nëpërmjet kësaj kontrate. Një pjesë e këtyre ekspertëve duhet të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë, ndërsa pjesa tjetër jo domosdoshmerisht të përfshirë në licensën e shoqërisë, dhe të përfshirë në listpagesat e shoqërisë.

- **Inxhinier Elektronik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për zërat e punimeve në preventiv, pasi kemi të bëjmë me instalimet elektronike. Inxhinieri elektronik do shërbejë në asistimin e inxhinierit elektroteknik për zbatimin dhe bashkërendimin e punëve në objekt duke qenë se kemi të bëjmë me një volum të konsiderueshëm punimesh.
- **Inxhinier Materialesh** është përgjegjës për zgjedhjen e materialeve të përshtatshme pasi analizon specifikimet teknike të produkteve që do të implementohen në veprë (duke shqyrtuar vetitë mekanike, termike, elektrike apo kimike) për të zgjedhur materialin më të përshtatshëm. Punon ngushtë me inxhinierë të tjerë për zgjedhjen e produkteve funksionale dhe të qëndrueshëm për të bërë të mundur që materialet e përdorura në objekt do të jenë në përputhje me specifikimet teknike.
- **Inxhinier Gjeoinformatik** Ndërtimi i sheshit, godinës si dhe linjave të jashtme të KUB është e nevojshme dhe e domosdoshme inxhinieri për zbatimin e projektit . Gjeoinformatika kombinon analizën gjeohapësinore dhe modelimin, zhvillimin e bazave të të dhënave gjeohapësinore, sistemet e informacionit, bashkëveprimin kompjuterik, dhe teknologjitë e rrjeteve me kabëll ose pa kabëll. Gjeoinformatika përdor gjeokompjuterizimin dhe gjeovizualizimin për të analizuar gjeoinformacionin.

2.9 Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar si staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar e kontrate pune te vlefshme, pajisur me diploma/certifikata te formimit profesional leshuar nga autoritete pergjegjese te akredituara/licensuara dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për periudhën **Maj 2025 – Qershor 2025**, konkretisht minimumi:

1 (një)	Teknik Ndërtimi
1 (një)	Teknik Topograf
2 (dy)	Teknik Hidraulik
1 (një)	Teknik Mekanik
1 (një)	Teknik Elektromekanik
8 (tetë)	Hekurkthyes
8 (tetë)	Karpentierë
2 (dy)	Hidraulikë
5 (pesë)	Specialist Gipsi
5 (pesë)	Bojaxhi
8 (tetë)	Duroalumini/durale
5 (pesë)	Pllakashtrues
6(gjashtë)	Betonues
6 (gjashtë)	Suvatues
4 (katër)	Murator
2 (dy)	Marangoz
3(tre)	Hidroizolues
2 (dy)	Termoizolues
6 (gjashtë)	Punetore per veshje fasadash
2 (dy)	Kopshtar
7 (shtate)	Elektricitë
5 (pesë)	Instalues te sistemeve te ngrohjes-ftohjes
3 (tre)	Pergatites te Konstruksioneve Metalike
4 (kater)	Saldatorë
4 (kater)	Automakinistë
3 (tre)	Manovratorë/Ekskavatoristë
7 (shtatë)	Shoferë (Drejtues mjeti)

Për keta punonjes, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (Diplomë profesionale/certifikate që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë ose ekuivalente.
- Për punonjesit manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:
kontratën individuale të punës te vlefshme ; leje drejtimi, certifikate e aftesise profesionale/Patente Manovrimi nga DPSHTRR.) (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën në SPE me të dhënat si më poshtë :

N r.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni /privat lëshues /diplomës	Nr. Amzes/ diplomes/certifik ates profesionale	nr.nipt ne rast se subjekti është privat
1					
2					
e tj					

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në kriterin mesipercituar është kërkuar që OE të kenë të punësuar teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Punëtorët e ndërtimit dhe profesionet e lidhura me to ndërtojnë, mirëmbajnë dhe riparojnë ndërtesat dhe strukturat e tjera që nga themelet, muret dhe pjesët e tjera kryesore të ndërtesës dhe konstruksione të tjera, si jashtë ashtu edhe brenda duke përdorur teknika dhe materiale tradicionale apo moderne të ndërtimit. Ata kryejnë punime murature, suvatime, shtrim pllakash dhe parketesh, lysterje me bojë etj. Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si vijon:

Për zbatimin e punimeve ndërtimore të tilla si punimet e gjurmimit, punimet strukturore, punimet e shtresave, rifiniturave, punimet e dymetave dhe dritareve, punimet hidraulike, punimet e tarracës, punimet e konstruksioneve metalike, punimet e sistemit në ter vëllimet e objektit janë kërkuar

- **Teknik ndërtimi**

Për zbatimin e punimeve ndërtimore të tilla si punimet e gërmimit, punimet strukturore, punimet e shtresave, rifiniturave, punimet e dyerve dhe dritareve, punimet hidraulike, punimet e tarracës, punimet e konstruksioneve metalike, punimet e sistemit në teresine e volumeve të objektit, ku grupet e ustallareve punojnë paralelisht brenda dhe jashtë është kërkuar 1 (nje) teknik ndërtimi. Kjo është një kërkesë shumë minimale, duke marrë parasysh vëllimin e madh të punimeve në periudha të gjata kohore do të punohet njëkohësisht.

- **Teknik Topograf**

Për zbatimin e punimeve ndërtimore të tilla si punimet e gërmimit, planet e strukturave, shtrimin e linjave të shkarkimeve të ujërave të ndotura si dhe të ujërave të bardha (KUB) është i domosdoshëm 1 (nje) teknik topograf për koordinimin e punës me ustallaret dhe punetoret të cilët do të punojnë në objekt me punimet e sipercituara.

- **Teknik Hidraulik**

Për zbatimin e punimeve ndërtimore të cilat përfshijnë instalimin e tubacione për ujë të pijshëm, ujë të nxehtë/ftohtë, kanalizime dhe pajisje sanitare si lavamanë, bojlerë si dhe referuar volumit të madh të punës për sistemin e sheshit (përkatesisht instalimit të linjave të KUB), bazuar në projektin dhe preventivin e punimeve është e domosdoshme prezenca e të paktën 2 (dy) teknike hidraulik.

- **Teknik Mekanik**

Për zbatimin e punimeve ku përfshihen projekti i rrjetit HVAC dhe projekti mekanik i mbrojtjes nga zjarri ku parashikohen punime të tilla si punime për instalimin e rrjetit të tubave të ujit, të sistemit qendror të sistemeve Hidrikë, Ashensori, punime për montimin e pajisjeve të kondicionimit, të pajisjeve të ajrit të freskët dhe ventilimit, si dhe punime për instalimin e sistemit MKZ dhe instalimin e pajisjeve respektive, instalim dhe montim i ashensorit. Të tilla punime do të realizohen në të gjithë vëllimet e objektit që ndërtohet. Kërkesa që OE të ketë të punësuar 1 (nje) teknik mekanik është kërkesë shumë minimale.

- **Teknik Elektromekanik**

Për zbatimin e punimeve ku përfshihen projekti montimi i motorëve elektrikë, pompave, dhe ashensorëve është i domosdoshëm të paktën 1 (nje) Teknik elektromekanik për të bërë të mundur bashkërendimin e punës së bashku me specialistet e tjera për punimet e sipercituara.

- **Hekurkthyes**

Në prevetivin e punimeve është parashikuar një sasi e madhe punimesh betoni dhe betonarmeje. Hekur betoni periodik është parashikuar në sasinë 608.31 ton. Hekurkthyesit nevojiten për realizimin e punimeve të tilla si matjet e duhura të hekurit duke respektuar tolerancat teknike, prerja e hekurit sipas përmasave të duhura duke eliminuar mbetjet (sa më pak firo), vendosjen e hekurit sipas specifikimeve të projektit, “mbjelljen” e kolonave në bashkëpunim me topografin ose inxhinierin e zbatimit për strukturat vertikale (kolona, mure anësore etj.), montimin (lidhjen) e hekurit sipas specifikimeve të përcaktuara, lidhjen e hekurave të soletës (që mund të jetë monolite ose e lehtësuar), etj. Për kthimin e hekurit të domosdoshëm për strukturat b/a janë kërkuar minimalisht 8 (tete) hekurkthyes.

Realizimi i punimeve të tilla lidhet me qëndrueshmërinë e të gjithë strukturës dhe duhet detyrimisht të realizohet nga punëtorë të kualifikuar. Ky kriter është minimal në raport me punimet e parashikuara në objekt.

- **Karpentier dhe Betonues**

Punimet e betonit dhe b/a të parashikuara në projektin konstruktiv, specifikimet teknike, prevetivin dhe grafikun e punimeve lidhen ngushtë me proceset e derdhjes së betonit, pjesë e të cilave është edhe përgatitja e kallëpëve. Krahas punimeve të betonit dhe betonarmesë parashikohet edhe ndërtimi i skelave krahas strukturave. Për realizimin e punimeve të tilla është e nevojshme që OE të zotërojë minimalisht 8 (tete) punëtorë të kualifikuar për realizimin e tyre, karpentierë. Sipas Listës Shqiptare të Profesioneve, të tillë punëtorë realizojnë punime të tilla si kryerjen e matjeve dhe prerjeve sipas përmasave të përcaktuara në projekt, bëjnë piketimin dhe armaturën anësore të themelit, bëjnë vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit sipas projektit, ndërtojnë armaturën, kallëpet e kolonave, mureve, shkallëve, urave apo strukturave të tjera, duke respektuar radhën e punës, me materiale druri, plastike, apo metalike sipas specifikimeve teknike, montojnë skelerinë përforcuese për fazën e betonimit të mureve dhe kolonave, kontrollojnë vertikalitetin e armaturës (peshon) me plumbçe, nxjerrin kuotat e lartësisë së katit sipas projektit (para betonimit), lagin armaturën para betonimit, ndërtojnë skelën për armaturën e trarëve dhe soletës duke ndjekur proceset e tjera të punës, vendosin polisterolin ose tullat në soletë apo në struktura të tjera (për rastin e soletave të lehtësuara), bëjnë disarmimin e kolonave, mureve dhe soletës apo strukturave të tjera duke respektuar afatet e duhura, kryejnë pastrimin dhe sistemimin e armaturës etj. Kërkesa që OE të ketë të punësuar minimalisht 8 (tetë) karpentierë dhe 6 (gjashtë) betonues është kërkesë minimale në raport me vëllimin e madh të punimeve.

- **Hidraulike**

Për realizimin e punimeve hidraulike në objekt janë kërkuar 2 (dy) hidraulikë. Hidrauliku sipas Listës Shqiptare të Profesioneve merret me ndërtime, montime, instalime, riparime dhe mirëmbajtje të sistemit hidraulik, të sistemit të ujësjellës kanalizimeve, të sistemit të ujitjes,

sistemeve të ngrohje-ftohjes, të sistemeve hidraulike të objekteve të prodhimit industrial dhe objekte të tjera që përdorin sisteme hidraulike të ngjashme. Ai monton, instalon, riparon dhe mirëmban pajisjet dhe aksesorët për ujë, gaz, kullim, kanalizim, pajisje të sistemeve të ngrohje-ftohjes, pajisje pneumatike etj. Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure parashikon punime për montimin dhe instalimin e rrjeteve dhe pajisjeve të furnizimit me ujë dhe shkarkimeve, si dhe pajisjeve të ngrohje ftohjes. Në total objekti i parashikuar të ndërtohet do të përmbajë një numër të konsiderueshëm tualetesh. Duke qenë se volumet e veçanta të ndërtesës (punimet hidraulike te brendshme dhe te jashtme , te rrjetit te furnizimit dhe shkarkimit te ujrave te bardha dhe te zeza) do të instalohen/ndertohen paralelisht me punimet e tjera sipas procesit.

- **Specialist Gipsi**

Për punimet e gipsit nga AK është kërkuar që OE të ketë të punësuar një numër minimal prej 5 (pese) specialist për punime gipsi. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti parashikon realizime të punimeve të ndërtimit të mureve dhe tavanëve me kartonxhes, etj. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës, për realizimin e të tilla punimeve.

- **Bojaxhi**

Për punimet e bojatisjeve të brendshme te mureve dhe tavanëve AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar minimalisht 5 (pese) bojaxhinj. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët në periudha të gjata do të punohet paralelisht.

- **Duroalumini/durale dhe marangoz**

Për punimet duroalumini, plastike, dyert e brendshme dhe fasaden e xhamit nga AK është kërkuar që OE të ketë të punësuar një numër prej 8(tete) specialist për punime duroalumini dhe 2 (dy) marangoz. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti parashikon realizime të punimeve të vendosjes se dyerve dhe dritareve,punime druri etj. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës dhe afatit kohor per realizimin e ketyre punimeve ne perputhje me grafikun e punimeve.

- **Pllakashtrues**

Për punimet e shtrimit dhe veshjes me pllaka gres, pllaka mermeri etj, Referuar Listës Shqiptare të Profesioneve, shtruesi i pllakave (pllaka shtruesi) dhe të tjerë që lidhen me to, instalon, mirëmban dhe riparon parkete dhe lloje të tjera të dysHEMEVE ose mbulojnë dysHemetë, muret ose sipërfaqet e tjera me pllaka ose panele mozaikësh për qëllime dekorimi ose të tjera. Punimet e parashikuara në këtë projekt parashikojnë shtrimin e të gjitha dysHEMEVE të kateve, shtrimin e sipërfaqeve të shkallëve, shtrimin dhe veshjen me pllaka të mureve të tualeteve etj. Këto punime në preventiv përfshijnë sipërfaqe të mëdha. Për realizimin e tyre AK ka kërkuar që OE të ketë të punësuar një numër minimal prej 5 (pese) pllakashtrues.. Ky numër është shumë minimal në raport me vëllimin e madh të punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët në periudha të gjata do të punohet paralelisht.

- **Suvatues**

Punimet e suvatimit të muraturës në objektin që ndërtohet parashikojnë suvatimet e të gjithë mureve të brendshme dhe të jashtme si dhe suvatimi i soletave në vëllimet që ndërtohen, Volumi I këtyre punimeve është shumë i madh dhe realizimi i tyre duhet të kryhet nga punëtorë të kualifikuar. Suvatuesit, sipas Listës Shqiptare të Profesioneve, realizojnë detyra të tilla si: Përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës, respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e duhura të materialeve përbërëse, bëjnë, hedhjen e spucos, vendosin fashot niveluese (peshimin në vertical dhe horizontal) mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashove me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, bëjnë kontrollin përfundimtar të punimeve, duke u siguruar që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt etj. Kërkesa për 6 (gjashtë) specialistë suvaje/suvatues është minimale.

- **Specialist murator**

Punimet e muraturës në objektin që ndërtohet parashikojnë ndërtimin e të gjithë mureve në vëllimet që ndërtohen. Vëllimi i këtyre punimeve është shumë i madh dhe realizimi i tyre duhet të kryhet nga punëtorë të kualifikuar. Muratorët, sipas Listës Shqiptare të Profesioneve, realizojnë detyra të tilla si: Përzgjedhin materialet e nevojshme dhe veglat e punës para fillimit të procesit të punës, respektojnë me rigorozitet radhën e kryerjes së çdo procesi pune sipas orientimit të dhënë në objekt, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, duke respektuar porcionet e duhura të materialeve përbërëse, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt, kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, vendosin arkitrarët e dyerve dhe dritareve, vendosin kondrakasat e dyerve dhe dritareve, nëse ka të tilla të

parashikuara në projekt, që gjithçka është sipas përshkrimit në projekt etj . Kërkesa për 4 (kater) muratorë është minimale.

- **Hidroizolues dhe termoizolues**

Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër të tjera realizimin e punimeve të hidroizilimit dhe punimet e tarracës. Këtu përfshihen të gjitha punimet dhe shtresat e lidhura me hidroizilimin për themelet, muret anësore të tyre, ambientet në kontakte me ujin si tualetet, hidroizolimin e tarracave etj. Punimet e termoizolimit që mbrojnë ndërtesën nga ndryshimet e jashtme të temperaturës dhe të mirëmbajnë temperaturë të këndshme e të qëndrueshme në pjesën e saj të brendshme. Për realizimin e punimeve të tilla në të gjithë vëllimet e objektit, në të cilët në periudha të gjata do të punohet paralelisht, kërkesa që OE të ketë të punësuar të paktën 3 (dy) hidroizolues dhe 2 (dy) termoizolues është kërkesë minimale në raport me vëllimin e madh të punës.

- **Punetore për veshje fasadash**

Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër të tjera realizimin e punimeve të fasades së jashtme. Punime të cilat kërkojnë specialiste të kualifikuar pasi kemi të bëjmë me fasade të ventiluara. Referuar volumit të punimeve marre nga preventive I punimeve si dhe grafikut të punimeve, për të garantuar cilësinë dhe afatin kohor për realizimin e këtyre punimeve kërkesa për 6 (gjashtë) punetore për veshje fasadash është minimale.

- **Kopshtar**

Projekti i zbatimit, objekt i kësaj procedure prokurimi parashikon ndër të tjera realizimin e punimeve për sistemit e jashtme ku referuar projektit arkitektonik si dhe preventivit të punimeve kemi të bëjmë me kompozim të hapsirave të reja që do të ndërtohen me hapesirat e gjelbra. Këto hapsira do të trajtohen me bar natyral, shkurre dhe pemë të ndryshme të cilat do të mbillen në përputhje me specifikimet e kërkuara, kërkesa për 2(dy) kopshtar është minimale.

- **Elektriçistë**

Për zbatimin e punimeve elektrike dhe elektronike, të tilla si punimet për kuadrot elektrike, sistemin e fuqisë dhe ndriçimit, sistemi i mbrotjes nga shkarkimet atmosferike dhe tokëzimi, tokëzimi i përsëritur të kuadri kryesor i godinës, punimet për motimin e gjeneratorit dhe kabinës elektrike, si dhe punimet për lidhjen e rrjeteve me infrastrukturën publike është kërkuar që

sipërmarrësi të ketë të punësuar të paktën 7 (shtate) specialist elektrikë. Këta punëtorë të kualifikuar, referuar Listës Shqiptare të Profesioneve merren me ndërtim, montim, instalim dhe riparim të sistemit elektrik në ndërtesa të ndryshme civile, objekteve social kulturore apo industriale etj. Elektracisti monton, instalon, riparon dhe mirëmban makineri dhe pajisjeve elektrike civile dhe industrial. Punimet elektrike zënë një vend të rëndësishëm në prevetivin total të punimeve, si nga pikëpamja e sasisë, ashtu edhe të vlerave. Konkretisht për kryerjen e punimeve për zërat e punimeve elektrike në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018*)

- **Instalues te sistemeve te ngrohjes-ftohjes**

Për zbatimin e punimeve, të instalimeve të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse , çillërave (sistemeve ngrohëse-ftohëse), si dhe kryen riparime apo punime mirëmbajtjeje në sistemet e ngrohje-ftohjes specialistet e sistemeve të ngrohje-ftohjes janë të domosdoshëm. Referuar prevetivit të punimeve janë shumë pajisje për tu montuar, pa llogaritur pajisjet e vogla, tubat dhe rakorderitë. Konkretisht për kryerjen e punimeve për zërat e punimeve për instalimin e kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse në mbështetje të Manualit të ndërtimit miratuar me Vendim nr.629, datë 15.07.2015 (*Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018*) kërkesa për 5 (pese) instalues të sistemeve të ngrohjes-ftohjes është kërkesë minimale.

- **Saldator dhe përgatites konstruksionesh metalike**

Për saldimin e elementëve metalikë në objekt kërkesas për 4 (kater)saldatorësh dhe 3 (tre) përgatites konstruksionesh metalike është kërkesë minimale. Punime të tilla duhet të realizohen me saktësi nga punëtorë të kualifikuar. Projekti parashikon realizime të shumë strukturave metalike, siç janë struktura të shkalleve të emergjences të cilat janë mjaftë të rëndësishme si dhe realizimin e strukture së fasades. Ky numër është shumë minimal në raport me volumeve të madh të punës, për realizimin e të tilla punimeve në të gjithë vëllimet e objektit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht:

- **Automakinist**

Për realizimin e punimeve ndërtimore për zbatimin e projektit, janë parashikuar këto makineri mbi bazë automjeti:

Makineri ndërtimi mbi bazë automjeti: autovinça, autobetoniere, autobetonpompa, Greider, damper. Manovratorëve u jepet Dëshmi për Automakinist.

Në total nevojiten minimalisht 4 (kater) automakinistë.

- **Eskavatorist**

Për manovrimin e makinerive të gjërmimi e ngarkimi dherash: vetëshkarkues, ngarkues-transportues, ekskavatorë, fadroma, ekskavatorë të kombinuar me pajisje shtesë, lopata ngarkuese (me goma dhe me zinxhirë). Manovratorëve duhet te jeten te pajisur me Dëshmi për Ekskavatoristë (për mjete me goma ose me zinxhirë);

Kjo kërkesë mbështetet në kategorizimet e përcaktuara në Urdhërin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 200, datë 16.5.2019 “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”, neni 8, pika 1a, sipas së cilës, *eskavator gjërmimi e ngarkimi dherash:- të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për ESKAVATORIST.*

Në total nevojiten minimalisht 3 (tre) eskavatoristë.

- **Shoferi**

Për realizimin e punimeve ndërtimore për zbatimin e projektit, janë parashikuar këto makineri mbi bazë automjeti:

Makineri ndërtimi mbi bazë automjeti: kamiona, kamiocina, rimorkiator , autobot uji etj sipas kërkesave të mjeteve.

Në total nevojiten minimalisht 7 (shtate) Shoferi.

2.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar personel të kualifikuar/certifikuar shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë **Maj 2025 – Qershor 2025**, të paktën;

1 (një) punonjës që disponon certifikatën si “Kordinator për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M-së nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 11. “Përpara nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon kandidateve të kualifikuar në fazën e parë, dorëzimin e dokumenteve provuese”, për përmbushjen e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme / Diplomë / Certifikatat e cituara më sipër. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

- 1 (një) punonjës që të disponojë Certifikatën e trajnimit si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e e rregullores “Për sigurinë në kantier”

Ose kontratë shërbimi me subjekte private të licensuara për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

- 1(një) punonjes i pajisur me certifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Operatori ekonomik për Saldatoret e deklaruar, të jenë të pajisur dhe certifikuar me: EN ISO 9606-1:135 PALTE FW FM1 S t12 PF ml, ss,mb për testimin e saldimit. Për përmbushjen e këtij kriteri do të pranohen vetëm certifikatat e lëshuara nga institucione të akredituara përkatëse ose ekuivalentin e tyre dhe kontratat e punës

- Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin”, Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/Certifikate si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpetimin).

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetëdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentim:

- Sipas **Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 9.2.2011**, për "Miratimin e rregullave të shëndetit dhe sigurisë në punë në kantieret e ndërtimit", çdo investitor apo punëdhënës është **i detyruar të emërojë një koordinator sigurie** në fazën e përgatitjes dhe zbatimit të projektit ndërtimor.

- Sipas **Ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”**, çdo subjekt punëdhënës është i detyruar të emërojë një punonjës të kualifikuar për mbikëqyrjen dhe zbatimin e masave të sigurisë në vendin e punës.
- Sipas **Ligjit nr. 10237/2010 dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 312, datë 5.5.2010**, çdo punëdhënës është i detyruar të marrë masa për ofrimin e **ndihmës së parë, shuarjen e zjarrit dhe evakuimin në raste emergjente**.

Argumentim: Projekti i zbatimit përmban të gjitha masat aktive dhe pasive të mbrojtjes nga zjarri, të paraqitura në materialet grafike të të gjithë projekteve, si dhe në prevetivin e punimeve, grafikun, relacionet dhe specifikimet teknike përkatëse. Masat për mbrojtjen nga zjarri përmbledhen në projektin e mbrojtjes nga zjarri. Zbatimi i saktë i të gjitha masave dhe punimeve për mbrojtjen nga zjarri është dmosdoshmëri dhe detyrim.

Në mbështetje të Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”, neni 39, pika 3, *projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në përdorim e veprave dhe strukturave të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor, elektrik, ujësjellës-kanalizimeve, pyjeve e kullotave, zonat e mbrojtura etj., bëhen në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.*

Referuar nenit 42 të po këtij ligji, *moszbatimi i projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në konstruksionet, objektet e ndërtimit, në ndërtesa të çdo lloji apo aktivitete që ushtrohen në to, ngarkon me përgjegjësi, sipas legjislacionit në fuqi, personat fizikë e juridikë që i kanë ato në pronësi ose në administrim.*

Për ndërtimin e ndërtesës, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2015, më sipër cituar dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi, është e nevojshme që të angazhohet 1 (një) ekspert zjarrfikës, i cili duhet të jetë pjesë e stafit inxhinierik të OE.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën h) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.11 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose

organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë të përcaktuara si më poshtë:

- **Certifikatë ISO 9001: - Certifikim për menaxhimin e cilësive ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO-mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe cdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO;
- **Certifikatë ISO 14001: - Sistemi i Menaxherial i Mjedisit ose ekuivalente** (e vlefshme për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe cdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO.
- **Certifikatë ISO 45001: - Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë ose ekuivalente**, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe cdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO.
- **Certifikatë EN ISO 3834-2: - Sistemi i Menaxhimit të cilësisë në saldim ose ekuivalente**, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe cdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO.
- **Certifikatë EN 1090: - Sistemi i Menaxhimit të cilësisë së prodhimit të strukturave metalike ose ekuivalente**, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të kontratës) për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, në mënyrë që OE të sigurojë një furnizim me cilësi dhe standarte evropiane, e cila duhet të jetë e akredituar nga institucione vendase (Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit) ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë. Duke qënë se kjo lloj certifikate ISO mund të ketë evoluar ndër vite do të pranohet edhe cdo lloj standarti tjetër i cili ka ardhur si evoluim i kesaj ISO.

Argumentimi. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 39, pika 8, dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e

rendësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit, shëndetit, sigurisë, saldimit dhe te prodhimit te strukturave metalike në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

2.12 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të jenë të pajisur me licensë leshuar nga QKL, “Kodi III.2.B” (*Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta*), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”*.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”*.

Nderkohe, sipas VKM Nr.538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: *“Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”*.

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Në preventivin e punimeve janë parashikuar punime prishje, ku krijohen mbetje të ndryshme, për transportin e të cilave nevojitet dhe është e domosdoshme disponimi i licences të kërkuar në këto kriter kualifikimi.

2.13 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e kontratës mjetet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë vijon;

Nr	Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton	3 copë	Në pronësi ose me qira
3	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10-12 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
4	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
5	Kamion me vinç me kapacitet mbajtës 5-10 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
6	Kamioncine me kapacitet mbajtës 1.5 – 2 ton	2 copë	Në pronësi ose me qira
7	Eskavator me zinxhirë	2 copë	Në pronësi ose me qira
8	Platforme ngritese elektrike mbi 15 m	1 copë	Në pronësi ose me qira
9	Grejder me goma me targa (MT)	1 copë	Në pronësi ose me qira
10	Rul ngjeshes hekur-gome kapaciteti mbi 16 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
11	Rul ngjeshes hekur-hekur kapaciteti 2-3 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
12	Vinç kulle me kapacitet mbajtës mbi 1.3 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
13	Rimorkiator për transport mjetesh të rënda	1 copë	Në pronësi ose me qira
14	Autovinç me kosh për punime në lartësi mbi 20 m	2 copë	Në pronësi ose me qira
15	Autobetonierë	4 copë	Në pronësi ose me qira
16	Autopompë betoni	1 copë	Në pronësi ose me qira
17	Dumper 3-5 m ³ me goma me targa (MT)	1 copë	Në pronësi ose me qira
18	Fadromë me goma me targa (MT)	1 copë	Në pronësi ose me qira
19	Eskavator me goma me targa (MT)	1 copë	Në pronësi ose me qira
20	Minieskavator mbi 5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
21	Minifadrome me goma me targa (MT)	2 copë	Në pronësi ose me qira
22	Autobot uji mbi 10,000 liter	1 copë	Në pronësi ose me qira
23	Autobetoniere kantieri 2-5 m ³ me goma me targa (MT)	2 copë	Në pronësi ose me qira
	Makineri Vijezi termoplastike (paste) jo me pak se 5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qira
24	Vibrator te jashtëm betoni	10 copë	Në pronësi ose me qira
25	Vibrator thellësie betoni	3 copë	Në pronësi ose me qira
26	Makineri lucidimi betoni	1 copë	Në pronësi ose me qira
27	Tokmak për ngjeshje dheu (kompaktor)	1 copë	Në pronësi ose me qira
28	Tranxhë për prerje hekuri	1 copë	Në pronësi ose me qira
29	Armature / lende drusore	1500 m ²	Në pronësi ose me qira
30	Pompe Nivelimi	2 copë	Në pronësi ose me qira
31	Matrapik	3 copë	Në pronësi ose me qira

32	Total station	1 copë	Në pronësi ose me qira
33	GPS	1 copë	Në pronësi ose me qira
34	Dron rtk	1 copë	Në pronësi ose me qira
35	Saldatriçe	1 copë	Në pronësi ose me qira
36	Pompe Suvatimi	1 copë	Në pronësi ose me qira
37	Sharre betoni	1 copë	Në pronësi ose me qira
38	Impiant Betoni (i pajisur me leje mjedisore)	1 copë	Në pronësi/me qira/kontrate furnizimi
39	Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore)	1 copë	Në pronësi/me qira/kontrate furnizimi

Mjete dhe paisje të mbrojtjese në punë:

- Kokore mbrojtëse 125 copë
- Jelekë 125 copë
- Ripa sigurimi 8 copë
- Fikse Zjarri 5 copë
- Tabela Sigurimi Teknik 16 copë
- Kutu Ndhmë e shpejtë 3 copë

Makineritë dhe paisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie origjinal ose fotokopje e noteruar.

- a) Makineritë dhe paisjet me qira të shoqërohen me kontrata e qiraje të vlefshme.
- b) Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet te mbuloje afatin e përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.
- c) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti,foto). Për paisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, orgjinale ose fotokopje e noteruar. Të gjitha mjetet dhe pajisjet e kërkuara te jenë të shoqëruara me foto.
- d) Per mjetet, pajisjet ngritese si dhe rripat e sigurimit OE duhet të paraqesin certifikatë të vlefshme inspektimi të lëshuar nga një organ i akredituar/licensuar.
- e) Autoriteti kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates dhe verifikimin e makinerive dhe pajisjeve ne terren .Ne rast deklarimi te rreme do te te veprohet ne perputhje me nenin 13 pika 3 germa a te ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 i ndyshuar ”per prokurimin publik”.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet “Deklaratë” nga administratori i shoqërisë ofertuese. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i’u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

1. *Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton (2 cope)* keto mjete janë kërkuar për transportin e materialeve të germuara dhe të krijuara nga prishja e objektit ekzistues gjithashtu do të shërbejnë për furnizimin me materialet e nevojshme për shtresat referuar kërkesave të projektit dhe preventivit.
2. *Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 15 ton (3 cope)* keto mjete janë kërkuar për transportin e materialeve të germuara dhe të krijuara nga prishja e objektit ekzistues gjithashtu do të shërbejnë për furnizimin me materialet e nevojshme për shtresat referuar kërkesave të projektit dhe preventivit.

3. *Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 10-12 ton (2 cope)* keto mjete jane kerkuar per transportin e materialeve te germuara dhe te krijuara nga prishja e objektit ekzistues gjithashtu do te sherbejne per furnizimin me materialet e nevojshme per shtresat referuar kerkesave te projektit dhe preventivit.
4. *Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 3.5-5 ton (2 cope)* keto do te sherbejne per furnizimin me materialet e nevojshme ne kantier referuar kerkesave te projektit dhe preventivit.
5. *Kamion me vinç me kapacitet mbajtes 5-10 ton (2 cope)* keto mjete do te sherbejne per furnizimin me materialet e nevojshme ne kantier referuar kerkesave te projektit dhe preventivit.
6. *Kamioncine me kapacitet mbajtes 1.5 – 2 ton (2 cope)* keto mjete do te sherbejne per furnizimin me materialet e nevojshme ne kantier referuar kerkesave te projektit dhe preventivit.
7. *Eskavator me zinxhirë (2 cope)* keto mjete do te sherbejne per kryerjen e punimeve te germimit per objektin civil dhe parkimin nentorkesor referuar kerkesave te projektit dhe preventivit.
8. *Platforme ngritese elektrike mbi 15 m (1 cope)* ky mjet do te sherbej per punimet te cilat kane te bejane me sistemimin e fasades si dhe te shkalleve te emergjences per te krijuar lehtesi, siguri dhe efikasitet per punimet ne lartesi.
9. *Grejder me goma me targa (MT) (1 cope)* ky mjet do te sherbej per hapjen dhe nivelimin e shtreses se stabilizantit. Duke qene se kemi nje hapsire te konsiderueshme sheshi ku eshte e domosdoshme ruajtja e kuotave per te bere te mundur drenazhimin e ujrave dhe per te realizuar punimet ne perputhje me grafikun e punimeve.
10. *Rul ngjeshes hekur-gome kapaciteti mbi 16 ton (1 cope)* ky mjet do te sherbej per ngjeshjen e shtreses se stabilizantit dhe te çakellit. Duke qene se kemi nje hapsire te konsiderueshme sheshi eshte e domosdoshme ngjeshja e tij per te krijuar nje strukture sa me te qendrueshme ne perputhje me kerkesat e specifikimeve dhe projektit te zbatimit.
11. *Rul ngjeshes hekur-hekur kapaciteti 2-3 ton (1 cope)* ky mjet do te sherbej per ngjeshjen e shtreses se stabilizantit ne zonat ne te cilat nuk ka akses rruli me kapacitet me te larte. Duke qene se kemi nje hapsire te konsiderueshme sheshi eshte e domosdoshme ngjeshja e tij per te krijuar nje strukture sa me te qendrueshme ne perputhje me kerkesat e specifikimeve dhe projektit te zbatimit.
12. *Vinç kulle me kapacitet mbajtes mbi 1.3 ton (1 cope)* ky mjet do te sherbej per ngritjen e materialeve ndertimore dhe shperndarjen ne katet perkatese.
13. *Rimorkiator për transport mjetesh të rënda (1 cope)* ky mjet do te sherbej per transportin e mjeteve te renda te cilat nuk jane te paisura me targa.
14. *Autovinç me kosh për punime ne lartësi mbi 20 m (1 cope)* ky mjet do te sherbej per punimet te fasades dhe montimin e strukures se saj (se bashku me elementet perberes). Duke qene se kemi te bejme me punime ne lartesi, referuar projektit dhe preventivit kerkesa

per nje mjet te tille eshte e domosdoshme pasi ben te munduar aksesimin e cdo piket te fasades duke ju permbajtur sigurise ne kantier.

15. *Autobetoniere (4 cope)* keto mjete do te sherbejne per transportin e betonit nga fabrika e prodhimit deri ne objekt. Duke qene qe kemi pllaken e objektit dhe pllaken e sheshit te cilat duhet te betonohen pa nderprerje kerkesa per kete numer mjetesh eshte e domosdoshme per realizimin e ketij proces pune.
16. *Autopompë betoni (1 cope)* ky mjet do te sherbej per hedhjen e betonit nga autobetonierja ne veper.
17. *Dumper 3-5 m3 me goma me targa (MT) (1 cope)* ky mjet do te sherbej per transport inerteve brenda objekti, dhe per heqjen e dherave gjate germime ne nje terren te veshtir ku nuk mund te futen kamionat.
18. *Fadromë me goma me targa (MT) (1 cope)* ky mjet do te sherbej per punimet e germimit dhe sistemimit te ambienteve te jashtme.
19. *Eskavator me goma me targa (MT) (1 cope)* ky mjet do te sherbej per punimet e sistemimeve te jashtme dhe hapjen e kanaleve per linjat nentokesore.
20. *Minieskavator mbi 5 ton (1 cope)* ky mjet do te sherbej per punimet e sistemimeve te jashtme dhe hapjen e kanaleve per linjat nentokesore.
21. *Minifadrome me goma me targa (MT) (2 cope)* keto mjete do te sherbejne per punimet e nivelimit dhe te sistemimeve te jashtme. Gjithashtu do te kryejne nje rol mjaft te rendesishem per transportin brenda kantierit duke qene se kemi nje volum te konsiderueshem.
22. *Autobot uji mbi 10,000 liter (1 cope)* ky mjet do te sherbeje per plotesimi e nevojave te objektit per furnizim me uje per sa i perket prodhimit te betonit te suvatimit dhe atij te shtresave, gjithashtu na nevojite per lagjen me uje te shtreses se stabilizantit para ngjeshjes pasi keme nje sasi te konsiderueshme sheshi.
23. *Autobetoniere kantieri 2-5 m3 me goma me targa (MT) (2 cope)* keto mjete do te sherbejne per prodhimin e betonit te shtresave dhe betoneve te cilave nuk kerkojne marke te larte. Referuar preventivit te punimeve dhe volumit te punes kerkesa per keto mjete eshte minimale.
24. *Makineri Vijezi termoplastike (paste) jo me pak se 5 ton (MT) (1 cope)* ky mjet do te sherbej per punimet e vijezi referuar preventivit dhe projektit. Bazuar ne volumen e larte ky mjet eshte i domosdoshem per te permushur cilesine e kerkuar ne veper.
25. *Vibrator te jashtem betoni (10 cope)* keto mjete jane te domosdoshem referuar volumit te madh te mureve te cilat do te realizohen ne parkimin nentokesor. Per te ulur ne maksimum poret ne beton cka sjellin permiresim te markes dhe fortesise se betonit kerkesa per keto mjete eshte e domosdoshme.
26. *Vibrator thellesie betoni (3 cope)* keto mjete jane te domosdoshem referuar volumit te betonit i cili do te hidhet ne veper gjate betonimit te kollonave trareve dhe soletave. Per te ulur ne maksimum poret ne beton cka sjellin permiresim te markes dhe fortesise se betonit kerkesa per keto mjete eshte e domosdoshme.
27. *Makineri lucidimi betoni (1 cope)* ky mjet eshte i domosdoshem per realizimin e punimeve te sheshit ku referuar specifikimeve teknike dhe preventivit te punimeve sheshi i betonit do te realizohet me beton i cili do te lucidohet pas hedhjes.

28. *Tokmak për ngjeshje dheu (kompatator) (1 cope)* ky mjet është i domosdoshëm për ngjeshjen e shtresave të cilat do të vendosen pas implementimit të linjave nentokesore për të na siguruar kompaktitet të lartë.
29. *Tranxhë për prerje hekuri (1 cope)* referuar sasise së konsiderueshme të hekurit periodik i cili do të përdoret në veper kërkesa për këtë mjet është e domosdoshme për realizimin e ketyre punimeve.
30. *Armature / lende drusore (1500 m2)* referuar sasise së konsiderueshme të betonit që do të hidhet në veper kërkesa për këtë sasi materiali është domosdoshme për realizimin e objektit.
31. *Pompe Nivelimi (2 cope)* referuar sasise së konsiderueshme të shtresave të betonit që do të hidhen në veper kërkesa për këtë mjete është e domosdoshme.
32. *Matrapik (2 cope)* duke qenë se kemi një sasi të konsiderueshme volum prishjesh, kërkesa për këtë mjete është e domosdoshme.
33. *Total station (1 cope)* kjo pajisje është e domosdoshme për shpërndajës të saktë të pikave dhe kuotave në objektin civil dhe në parkimin që do të ndërtohet.
34. *GPS (1 cope)* kjo pajisje është e domosdoshme për shpërndajës të saktë të pikave dhe kuotave përgjatë sheshit të ri që do të ndërtohet si dhe për linjat e shkarkimeve të KUB e atyre të ndotura.
35. *Dron rtk (1 cope)* kjo pajisje është e domosdoshme gjatë procesit të azhurnimit të objektit për sa u përket sistemeve të jashtme duke bërë marrjen e pikave dhe vizualizimin në ortofoto me një saktësi të lartë.
36. *Saldatriçe (1 cope)* kjo pajisje është e domosdoshme për punimet e struktura të fasadës si dhe shkallët e emergjencës të cilat do të realizohen me konstrukcione metalike.
37. *Pompe Suvatimi (1 cope)* kjo pajisje është e domosdoshme referuar volumit të lartë të suvatimit që do të kryhen në këtë objekt.
38. *Sharre betoni (1 cope)* kjo pajisje është e domosdoshme për punimet e prerjeve të betonit referuar natyrës së punës me të cilën kemi të bëjmë.
39. *Impiant Betoni (i pajisur me leje mjedisore) (1 cope)* do të shërbejë për prodhimin e betonit që do të hidhet në veper referuar preventivit të punimeve.
40. *Nyje Inerte (e pajisur me leje mjedisore) (1 cope)* do të shërbejë për prodhimin e inerteve që duhen për realizimin e këtij objekti.

2.14 Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të garantojnë furnizim me materialet kryesore për realizimin e objektit të prokurimit. Konkretisht kërket Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për materialet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i materialit	Tipi/Lloji	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. Kontakti
1	Elektrike (kabull, ndricuesit, automat , pajisje)		
2	Sistemi i mbrojtjes nga zjarri		
3	Hidraulike (tuba, pajisje hidrosanitare)		
4	Kondicionimi ngrohje-ftohje		
5	Ashensor		
6	Gipse		

7	Fasade e ventiluar, perfshi te gjithë elementet e nevojshem te montimit per elementet termoizolues dhe ate dekorativ ne fasade si ne detaje		
8	Pompat		
9	Bojra		
10	Vetrate xhami fasade si ne detaje		
11	Dyer emergjence		
12	Paisje IT		

2.15/a Për materialet e tabelës së dhënë në pikën 2.14, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto materiale. Në rast paraqitje autorizim distributori autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore te kerkuara.

2.15/b Të paraqiten katalogët/skedë teknike nga prodhuesi/prodhuesit për të gjitha materialet sipas pikës 2.14 si dhe deklaratë/Çertifikatë Konfirmimit CE ose raportet e testimit të lëshuara nga ente çertifikues të akredituar kombëtar ose ndërkombëtar .

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

Tabela është e detyrueshme për tu plotësuar për të gjithë artikujt e listuar. Mosplotësimi i kësaj table është kusht skualifikues.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të Nenit 44, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar). Operatori ekonomik bazuar në preventivin e punimeve objekt kontrate, ku përveç vendosjes është parashikuar dhe furnizimi i materialeve, referuar natyrës së tyre, ku disa prej tyre duhet të jenë të një cilësie të mirë, referuar kostos së tyre dhe funksionit që kanë, me qëllim që të kenë një jetëgjatësi përtej periudhës së garancisë që kanë, vlerëson se operatorët ekonomik duhet të paraqesin dokumentacionin që vërteton lidhjen me prodhuesin ose distributorin e autorizuar nga do t’i sigurojnë këto materiale objekt kontrate, katalogët e pajisjeve/ materialeve, deklaratë/Çertifikatë Konfirmimit CE ose raportet e testimit të lëshuara nga ente çertifikues të akredituar kombëtar ose ndërkombëtar, si dhe dokumentacionin me të dhënat e këtyre materialeve, **me qëllim verifikimin/ vlerësimin nga A.K , nëse këto materiale/ pajisje për të cilat do të ofertojnë operatorët ekonomik pjesëmarrës janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat e tenderit**, si dhe janë të prodhuara nga prodhues të çertifikuar për prodhimin e tyre me cilësi dhe brenda standarteve të miratuara. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshem Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontrates.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventiv si dhe për shkak të interesit të lartë që objekti duhet të garantohej që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjykojmë të domosdoshme të garantohej që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

2.16 Operatorët ekonomik duhet të kenë kontratë noteriale më një laborator testimi të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtar ose ndërkombëtar sipas standarteve SSH EN 12390-7:2019, SSH EN 12350-2:2009, SSH EN 12504-2:2012, SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019

Argumentim: Kërkesat për piken e mesipërme është bërë pasi referuar volumit të madh të betonit i cili do të hidhet në veper është i domosdoshëm kontrolli periodik dhe testimi i betonit për të garantuar cilësinë në përputhje me specifikimet teknike.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga drejtoria e projekteve, pjesë perberese e strukture së **Bashkisë Kamez**, që ka hartuar edhe projektin përkatës të zbatimit duke qenë elemente perberes të tij. Në hartimin e tyre janë marrë në konsiderat kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të Ligjit nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kërkesat e ligjit të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e

mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikime teknike, projekti, preventivi, grafiku dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në DT, me të dhenat e mëposhteme:

Dokumentat e tenderit me kërkesat si më sipër firmosen nga anëtarët e njësisë së prokurimit, pas miratimit të gjithë anëtarëve të njësisë kanë akses (autorizohen) për botimin e tyre në rrugë elektronike pranë APP(www.app.gov.al).

Njësia e Prokurimit